

NJË ZË PA BARRIERA: ANALIZA E PJESËMARRJES SË PERSONAVE TË VERBËR NË ZGJEDHJE



3 HYRJE

4 RRETH ORGANIZATORËVE

5 KORNIZA LIGJORE

8 QASJA METODOLOGJIKE

10 ANALIZË PERSONAT E VERBËR

Të dhënat demografike dhe gjeografike

Gjetjet nga hulumtimi i personave të verbër të anketuar

21 ANALIZË-ASISTENTËT PERSONALË

Të dhëna demografike dhe gjeografike

Gjetjet nga analiza e përgjigjeve të asistentëve personal

25 REKOMANDIME

NJË ZË PA BARRIERA: ANALIZA E PJESËMARRJES SË PERSONAVE TË VERBËR NË ZGJEDHJE është analizë në kuadër të projektit zviceran të programit për mbështetje zgjedhore të zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES).

Përmbajtja/opinionet/ nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë pikëpamjet e Qeverisë së Zvicrës dhe Fondacionit ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES).



HYRJE

Në prag të zgjedhjeve të ardhshme lokale në vitin 2025, është veçanërisht e rëndësishme të sigurohen kushtet e pjesëmarrjes së barabartë të të gjithë qytetarëve në kohën e duhur. Kjo nënkupton gjithashtu ndërmarrjen e masave specifike për personat me aftësi të kufizuara, si pjesë e një zotimi më të gjerë për një proces zgjedhor të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Në Maqedoninë e Veriut personat me aftësi të kufizuara kanë pjesëmarrje të kufizuar në jetën politike, gjë që është pasojë e qasjes mjekësore afatgjatë[1] që i trajton ata si objekt kujdesi, në vend se si qytetarë të barabartë. Pjesëmarrja në zgjedhje paraqet mundësi kryesore për përfshirjen e tyre politike dhe ushtrimin e të drejtave civile. Edhe pse procesi është i mbushur me sfida, pikërisht nëpërmjet zgjedhjeve hapen mundësi për kapërcimin e barrierave dhe forcimin e demokracisë në dobi të të gjithë qytetarëve.

Sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në shtet jetojnë 94,412 persona me aftësi të kufizuara. Prej tyre, 12,371 persona kanë aftësi të kufizuara vizuale. Këto shifra tregojnë qartë praninë e konsiderueshme të këtij grupi në shoqëri dhe domosdoshmërinë që nevojat e tyre të merren parasysh gjatë organizimit të zgjedhjeve.

Pikërisht këta dy faktorë, zgjedhjet e shpallura lokale të vitit 2025 dhe të dhënat zyrtare statistikore që janë në dispozicion për herë të parë për personat me aftësi të kufizuara, ishin stimujt e kryerjes së kësaj Analize.

Analiza bazohet në përgjigjet e vetë personave të verbër dhe asistentëve të tyre personalë, të cilët ndanë përvojat e tyre të pjesëmarrjes në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 dhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale në maj të vitit 2024. Këto përvoja ofrojnë një pasqyrë të drejtpërdrejtë të barrierave reale me të cilat përballen këta persona, por në të njëjtën kohë ato hedhin dritë edhe mbi praktikatat pozitive mbi të cilat mund të mbindërtohen. Pasqyra e këtillë paraqet një burim të vlefshëm informacioni që mundëson të identifikohen prioritetet për përmirësimin e procesit zgjedhor, veçanërisht në prag të zgjedhjeve lokale të vitit 2025.

Duke marrë parasysh edhe kufizimet e vërejtura në metodologjinë dhe fushëveprimin, analiza megjithatë paraqet një bazë të fortë për punën e mëtejshme. Ajo e tregon realitetin e dyfishtë: nga njëra anë, nevojën për një fushëveprim më sistematik dhe më të gjerë në mënyrë që të merren të dhëna më të detajuara dhe të qëndrueshme; nga ana tjetër, shihet qartë potenciali që rezultatet e fituara të përdoren si katalizator për ndryshime pozitive. Gjetjet nuk janë vetëm një kontribut akademik, por kanë edhe vlerë praktike - ato ofrojnë një pikënisje argumentuese për institucionet dhe politikëbërësit, për organizatat e shoqërisë civile dhe për vetë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Përmes tyre, të gjithë palët e interesuara fitojnë një bazë konkrete për përfaqësimin dhe zhvillimin e politikave dhe praktikave që do të mundësojnë zgjedhje më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe më demokratike.

[1] Qasja mjekësore e shih aftësinë e kufizuar si një problem shëndetësor që trajtohet nëpërmjet diagnozës dhe terapisë. Qasja moderne është gjithëpërfshirëse, që synon heqjen e barrierave dhe pjesëmarrjen e plotë në shoqëri, duke përfshirë edhe procesin zgjedhor.

RRETH ORGANIZATORËVE

Analiza është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Shoqatës ESI NELIS dhe Programit për mbështetjen e zgjedhjeve, i cili është projekt i Qeverisë së Zvicrës i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES).

Shoqata ESI NELIS nga Shkupi ekziston që nga viti 2020 dhe përmes aktiviteteve të saj angazhohet të përmirësojë cilësinë e jetës së personave të verbër dhe personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Organizata punon në projekte të natyrave të ndryshme, por fokusi i saj kryesor është mbështetja e personave me aftësi të kufizuara përmes kurseve edukative dhe trajnimeve për personat e verbër dhe asistentët e tyre personalë, si dhe për asistentët personalë për ndihmë personale për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. Qëllimet kryesore të shoqatës janë: respektimi i të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, inicimi i zgjidhjeve të përmirësuara ligjore për mbrojtje më efektive, inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara të mbështeten në forcat dhe aftësitë e tyre, promovimi i autonomisë së tyre si përdorues të shërbimeve, si dhe sigurimi i mbrojtjes ekonomike, sociale, shëndetësore dhe ligjore, drejtësisë sociale dhe sigurisë.

Programi për Mbështetjen e Zgjedhjeve është një projekt i Qeverisë së Zvicrës i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES). Programi ka për qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e proceseve zgjedhore përmes forcimit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e zgjedhjeve, mbështetjes së transparencës dhe llogaridhënies, si dhe rritjen e përfshirjes së qytetarëve në procesin zgjedhor. Vëmendje e veçantë i kushtohet çështjeve që lidhen me barazinë, përfshirjen dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike, me qëllim sigurimin e zgjedhjeve të drejta dhe të besueshme në vend.

KORNIZA LIGJORE

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrja e tyre në proceset zgjedhore rregullohen në disa akte të rëndësishme ligjore:

o Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila siguron barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar, me ç'rast e drejta e votës është e drejtë e garantuar kushtetuese për të gjithë qytetarët madhorë.

o Kodi zgjedhor është ligji kryesor i cili rregullon procesin zgjedhor[2]. Në të janë paraparë aspektet e mëposhtme relevante për personat me aftësi të kufizuara:

- E drejta e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në zgjedhje në kushte të barabarta me të gjithë qytetarët e tjerë.
- Mundësia e votimit me asistencën e një personi tjetër sipas zgjedhjes së votuesit, në rast se ai/ajo nuk mund të votojë në mënyrë të pavarur.
- Detyrimi i këshillave zgjedhore që të sigurojnë kushte për ushtrimin e papenguar të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara.
- Detyrimi për përshtatjen e vendvotimeve në përputhje me parimet e qasshmërisë dhe mosdiskriminimit.

Më hollësisht, detyrimet dhe të drejtat e lartpërmendura rregullohen përmes neneve të ndryshme të Kodit Zgjedhor të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

[2] https://drive.google.com/file/d/1yOTG7wVUyNoUk1_AkIYrNbD4gHQWzS5y/view

Neni i KZ	Përmbajtja	E drejtë/Detyrim
Neni 75	Servisi radiodifuziv publik dhe stacionet televizive kombëtare janë të detyruara të transmetojnë përmbajtje zgjedhore të arritshme për personat me aftësi të kufizuara (gjuhë shenjash, titra, përshkrim audio).	Detyrim për qasje të barabartë në informacion.
Neni 75-a	Njoftimi i zgjedhjeve duhet të jetë i ekuilibruar dhe i arritshëm në format dhe gjuhë të kuptueshme për të gjithë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.	Garanci për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim.
Neni 111	Votimi është i fshehtë, personal dhe zhvillohet me sigurimin e kushteve, që garantojnë qasshmëri dhe barazi për të gjithë votuesit.	E drejtë themelore e pjesëmarrjes së barabartë e të gjithë votuesve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.
Neni 112	Votuesi i cili nuk mund të votojë në mënyrë të pavarur ka të drejtë të kërkojë asistencë nga personi i zgjedhur sipas zgjedhjes së tij; nëse nuk e sjell personin e tij, Këshilli Zgjedhor emëron një person tjetër nga radhët e votuesve.	E drejtë për votim me ndihmë.
Neni 112-a	Këshilli Zgjedhor është i detyruar të sigurojë kushte për votim për personin me aftësi të kufizuara i cili nuk mund të hyjë në vendvotim, në përputhje me Udhëzimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.	Detyrim i Këshillit Zgjedhor për sigurimin e kushteve.
Neni 164	Gjatë rregullimit dhe pajisjes së vendvotimeve, duhet të sigurohen kushte për funksionalitetin, sigurinë dhe qasshmërinë e tyre, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.	Detyrim për qasshmëri dhe rregullim adekuat të vendvotimeve.
Neni 173-a	Institucionet dhe organet të cilat posedojnë objekte ku janë të vendosura vendvotimet janë të detyruara t'i përshtatin ato për qasjen e të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara.	Detyrim për përshtatjen e vendvotimeve.

Tabela 1: Dispozitat e Kodit Zgjedhor që lidhen me personat me aftësi të kufizuara

Përveç Kodit Zgjedhor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e rregullon çështjen e votimit të personave me aftësi të kufizuara edhe përmes udhëzimeve të hollësishme, siç janë:

1. Udhëzimi[3] për zbatimin e nenit 112-a të Kodit Zgjedhor e rregullon procedurën e votimit të personave me aftësi të kufizuara që nuk mund të hyjnë në mënyrë të pavarur në vendvotim. Në rastet e këtilla, Këshilli Zgjedhor është i detyruar të sigurojë kushte adekuate për qasjen dhe ushtrimin e të drejtës së votës. Sipas këtij udhëzimi, votuesve u mundësohet të votojnë me asistencën e shoqëruesit. Në këtë rast, votuesi ka të drejtë të zgjedhë vetë një person i cili do ta ndihmojë atë. Nëse votuesi vjen pa shoqërues, Këshilli Zgjedhor emëron një person nga radhët e votuesve të pranishëm i cili do ta kryejë këtë rol.

2. Udhëzimi për votimin e personave të verbër dhe personave me shikim të dëmtuar[4] ku ndër të tjera rregullohet edhe përdorimi i shabllonit për votim i përpunuar me alfabetin e Brajtit (shablloni i Brajtit), me qëllim që personat e verbër të votojnë në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë. Ky Udhëzim ekziston edhe në formën e regjistrimit audio^[5] që është në dispozicion në ueb-faqen e KSHZ-së.

3. Sipas Udhëzimit për paraqitjen e votimit të personave të pafuqishëm dhe të sëmurë^[6], personat me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe personat e verbër dhe personat me shikim të kufizuar, kanë mundësi që të ushtrojnë të drejtën e tyre zgjedhore në kushte shtëpiake. Edhe pse kjo paraqet një masë lehtësuese për ata që nuk mund të votojnë në vendvotim, ata evidencohen formalisht si "persona të pafuqishëm dhe të sëmurë", dhe jo si votues me aftësi të kufizuara.

o Ligji i Mbrojtjes Sociale[7] në të cilin përcaktohen asistentët personalë si një shërbim mbështetës që siguron qasje të barabartë në shërbime dhe të drejta. Në kontekstin e zgjedhjeve, roli i asistentit personal njihet në mënyrë indirekte përmes dispozitës që një votues me aftësi të kufizuara mund të shoqërohet nga një person tjetër sipas zgjedhjes vetjake. Në praktikë, ky është shpesh asistenti personal. Në këtë mënyrë, asistentët personalë paraqesin urë ndërmjet garancisë ligjore të së drejtës së votës dhe përdorimit të tij praktik.

o Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi^[8], me ç'rast ky ligj garanton barazinë dhe ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar në të gjitha sferat e jetës shoqërore, përfshirë edhe proceset zgjedhore.

o Më 5 dhjetor të vitit 2011, Republika e Maqedonisë së Veriut ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përfshirë Nenin 29, i cili ka të bëjë me pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike. Që atëherë, shteti ynë mori përsipër detyrën për zbatimin e dispozitave të Konventës duke i detyruar shtetet që:

- Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në jetën politike dhe publike.
- Të garantojnë votimin e fshehtë, qasshmërinë në vendvotimet dhe mundësinë e përdorimit të asistentëve personalë ose mjeteve ndihmëse si shablloni i Brajtit.
- Të miratojnë masa ligjore dhe praktike që do të lehtësojnë pavarësinë e personave me aftësi të kufizuara gjatë votimit.

[3] [2.-Упатство-за-примена-на-член-112-а-од-Изборниот-законик-за-лица-со-попеченост.pdf](#)

[4] https://drive.google.com/file/d/1VHcN-trOh925Anc_n_M1PN4tCoCNI4HJ/view

[5] <https://www.sec.mk/upatstvo-za-glasanje-na-slepi-lica-i-lica-so-oshteten-vid-2/>

[6] [7.-Упатство-за-пријавување-и-гласање-на-немоќно-или-болно-лице.pdf](#)

[7] https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2019/28.5_zakon_SZ.pdf

[8] <https://mtsp.gov.mk/content/>

[Закон%20за%20спречување%20и%20заштита%20од%20дискриминација.pdf](#)

QASJA METODOLOGJIKE

Analiza është përpiluar në bazë të të dhënave sasiore dhe cilësore të mbledhura përmes pyetësorëve të strukturuar anketues. Hulumtimi ka për qëllim që të sigurojë një vështrim sistematik në përvojat e personave të verbër dhe asistentëve të tyre personalë në lidhje me ushtrimin e të drejtës zgjedhore dhe sigurimin e mbështetjes përkatëse në procesin zgjedhor.

Hulumtimi përfshin dy grupe të synuara:

- Personat plotësisht të verbër (më tej në tekst "persona të verbër"), d.m.th., të anketuarit që janë votues të regjistruar dhe plotësojnë kushtet dhe përdorin shërbimet e asistencës personale; dhe
- Asistentët personalë: personat që sigurojnë mbështetje për personat e verbër në funksionimin e përditshëm, përfshirë edhe gjatë procesit zgjedhor.

Analiza është kryer mbi përgjigjet e marra nga 252 të anketuar persona të verbër dhe 225 të anketuar asistentë personalë.

Hulumtimi përfshiu gjithsej 32 komuna të shpërndara në këto njësi zgjedhore:

Njësia zgjedhore	Numri i komunave	Komunat
NjZ 1	6	Aerodrom, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Studeniçan
NjZ 2	6	Butel, Çair, Gjorçe Petrov, Gazi Babë, Haraçinë, Kumanovë
NjZ 3	5	Sveti Nikollë, Zërnovc, Koçan, Çeshinovë-Obleshevë, Shtip
NjZ 4	7	Bogdanc, Gjevgjeli, Dojran, Kavadar, Krivogashtan, Negotinë, Prilep
NjZ 5	5	Manastir, Kërçovë, Krushevë, Ohër, Strugë
NjZ 6	3	Bërvenicë, Tearcë, Tetovë

Tabela 2: Komunat e përfshira në analizë sipas Njësive Zgjedhore

Lidhur me instrumentet dhe të dhënat e përdorura për këtë analizë u përdorën dy pyetësorë anketues.

Pyetësor anketues për personat e verbër në të cilin janë përzgjedhur:

- Të dhënat demografike (gjinia, mosha, komuna, përkatësia etnike).
- Njohuritë për alfabetin e Brajlit dhe përdorimi i formave alternative për votim.
- Pyetjet lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje, vendin e votimit, nevojën e mbështetjes dhe shërbimet e marra.

Pyetësor anketues dedikuar asistentëve personalë. Përmes tij janë përzgjedhur të dhënat në lidhje me:

- Të dhënat demografike (gjinia, mosha, komuna, përkatësia etnike).
- Pyetjet për arsimin formal dhe trajnimet për procesin zgjedhor.
- Pyetjet rreth përvojës me shoqërimin e personave të verbër gjatë votimit.

Të dhënat janë mbledhur gjatë muajit maj të vitit 2025 nëpërmjet aktiviteteve në terren, pra duke plotësuar pyetësorin për personat e verbër nga asistenti dhe duke plotësuar drejtpërdrejt pyetësorin për asistentët nga asistentët e angazhuar. Plotësimi ishte vullnetar dhe anonim, me pëlqimin e siguar prej të anketuarve. Gjithashtu, është respektuar në mënyrë përkatëse parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Përpunimi dhe analiza e të dhënave është bërë ashtu që të dhënat nga pyetësorët janë futur dhe përpunuar në tabelat e MS Excel-it. Për këtë qëllim janë përdorur statistika deskriptive për përshkrimin e përgjigjeve. Për përcjelljen më të lehtë të gjetjeve janë përpunuar paraqitje grafike (bar-grafikë) për vizualizimin e rezultateve. Si plotësim, është kryer një analizë tematike e përgjigjeve të hapura për të identifikuar sfidat specifike dhe sugjerimet për përmirësime.

Kufizimet e kësaj qasjeje metodologjike i referohen mostrës prej 252[9] personave të verbër në raport me 12.371 personave të verbër[10] në nivelin shtetëror që mbart marginën e gabimit prej rreth $\pm 6.1\%$ (me 95% interval besimi). Hulumtimi mbulon vetëm 32 komuna, përkatësisht më pak se gjysmën e të gjitha komunave në vend, kështu që rezultatet nuk e pasqyrojnë gjendjen në 48 komunat tjera. Shtrirja e këtillë e kufizon mundësinë për një analizë më të thellë sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike dhe faktorëve të tjerë, ndërsa numri i vogël për komuna nuk lejon zbulimin e specifikave të plota lokale.


[9] Një pjesë e pjesëmarrësve nuk kanë dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet.

[10] Enti Shtetëror i Statistikës-Regjistrimi i popullsisë 2021 https://www.stat.gov.mk/Aktivnosti_en.aspx?rbra=320

ANALIZË: PERSONAT E VERBËR


TË DHËNAT DEMOGRAFIKE DHE GJEOGRAFIKE

Analiza bazohet në përgjigjet e 252 personave të verbër, me një profil shprehimisht të qartë gjinor dhe moshor. Gratë marrin pjesë me 103 të anketuara, ndërsa burrat me 149 të anketuar. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve i përket grupmoshës mbi 50 vjet (67%), gjë që tregon një përfaqësim më të lartë të gjeneratave më të moshuara, ndërsa të rinjtë deri në 29 vjet janë përfaqësuar vetëm me 6%. Përbërja etnike pasqyron gjithashtu diversitetin në vend: shumica e të anketuarve janë maqedonas (180), vijojnë shqiptarët (42) dhe romët (17).



Grafiku 1/2/3: Përfaqësimi i pjesëmarrësve sipas gjinisë, moshës dhe etnisë

Shpërndarja gjeografike e të anketuarve përfshin 32 komuna, me përfaqësimin më të lartë në Kërçovë, Koçan dhe Prilep.



Grafiku 4: Numri i pjesëmarrësve sipas komunës

Përfaqësimi gjeografik



Të dhënat tregojnë se madje 92% e pjesëmarrësve jetojnë në komuna jashtë Shkupit, gjë që tregon se Analiza i përpunon përvojat e formësuar nga kushtet në zonat më të vogla dhe rurale. Ky rezultat thekson nevojën për vëmendje të veçantë ndaj qasshmërisë dhe shërbimeve jashtë kryeqytetit, ku barrierat janë shpesh më të theksuara.

Grafiku 5: përqindja e pjesëmarrësve nga Shkupi dhe jashtë Shkupit


GJETJET NGA HULUMTIMI I PERSONAVE TË VERBËR TË ANKETUAR

Sa njihet shkrimi i Brajit?

Shkrimi i Brajit është një mjet themelor për komunikim me shkrim dhe qasje në informacion për personat me shikim të dëmtuar. Përdorimi i tij është i lidhur ngushtë me mundësinë për arsim, punësim dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe politike, përfshirë këtu edhe procesin zgjedhor.

Edhe pse sistemi arsimor ofron mundësi për të mësuar shkrimin e Brajit përmes institucioneve të specializuara dhe Qendrës së Arsimimit dhe Rehabilitimit të Personave me Shikim të Dëmtuar, vetëm një pjesë e kësaj popullate e ka zotëruar në mënyrë aktive dhe e përdor në jetën e përditshme.

Me zhvillimin e teknologjive të reja siç janë audiolibrat, lexuesit e ekranit dhe aplikacionet mobile dhe mjetet e tjera, po vërehet tendencë në reduktimin e përdorimit të përditshëm të shkrimit Braj, megjithëse roli i tij mbetet i pazëvendësueshëm në segmente të caktuara. Është veçanërisht i rëndësishëm kontributi në procesin zgjedhor : që nga viti 2017, KSHZ-ja ka siguruar shabllonet e Brajit për fletët e votimit, me qëllim që të garantohej sekreti i votës dhe i barazisë së pjesëmarrjes.



Grafiku 6/7: Numri i pjesëmarrësve që njohin alfabetin e Brajit dhe ndarja sipas përkatësisë etnike

Përgjigjet e personave të verbër të anketuar konfirmojnë perceptimin shqetësues për zotërimin e pamjaftueshëm të shkrimit Braj. Pothuajse 80% prej tyre nuk e njohin fare alfabetin e Brajit, një e dhënë që tregon se shumica e personave me shikim të dëmtuar janë të privuar nga mjeti themelor i arsimimit, pavarësisht dhe qasjes së informacionit. Kjo situatë është veçanërisht e theksuar në mesin e të anketuarve të bashkësisë etnike maqedonase dhe turke, gjë që ngre pyetje lidhur me qasjen e pabarabartë në arsim dhe në burime. Kjo nuk është vetëm një sfidë arsimore, por edhe një problem serioz demokratik: pa zotërimin aktiv të shkrimit Braj, pjesa e madhe e komunitetit është e kufizuar në mundësinë e pjesëmarrjes në mënyrë të barabartë në shoqëri dhe në procesin zgjedhor.



Grafiku 8/Tabela 3: numri i pjesëmarrësve që e njohin alfabetin Brajit në Shkup dhe jashtë Shkupit dhe ndarja sipas moshës.


Analiza tregon dallime të qarta në njohjen e shkrimit Braj sipas vendbanimit dhe moshës. Të anketuarit nga qyteti i Shkupit kanë një nivel për 30% nivel më të lartë njohjeje krahasuar me ata të komunave tjera, duke treguar se mjedisi urban ofron qasje më të madhe në arsim dhe burime. Një pamje e ngjashme shihet në hendekun e gjeneratave: të rinjtë deri në 29 vjet në masë më të madhe konfirmojnë njohjen e shkrimit Braj, ndërsa mosnjohja më e madhe është vërejtur te personat mbi 65 vjet.

Nga gjithsej 252 të anketuar, vetëm 12 deklaruan se kishin ndjekur trajnime mbi votimin e personave të verbër, me ç'rast të gjitha këto trajnime ishin organizuar nga organizatat joqeveritare. Këto të dhëna tregojnë qartë se përpjekjet e deritanishme për edukim janë sporadike, nuk përfshijnë komunitetin e gjerë dhe varen kryesisht nga iniciativat e sektorit civil. Mungesa e mbështetjes institucionale krijon rrezikun që një numër i madh i personave të verbër të mbeten pa njohuritë dhe aftësitë praktike të nevojshme për votim të pavarur dhe të fshehtë. Për këtë gjë, është e nevojshme të vendoset një qasje sistematike. KSHZ-ja, institucionet arsimore, me përfshirjen e sektorit civil, duhet të investojnë përpjekje të mëtijshme në zhvillimin dhe zbatimin e rregullt të programeve të trajnimit në përgjithësi, por edhe me fokus tek personat e verbër në zonat rurale dhe popullatën e moshuar. Vetëm përmes një bashkëpunimi të tillë të institucionalizuar mund të sigurohet vazhdimësia dhe përfshirja më e gjerë e personave të verbër në procesin zgjedhor.

Procesi zgjedhor dhe heqja dorë nga e drejta zgjedhore

E drejta e votës është themeli i demokracisë, ndërsa pjesëmarrja e personave të verbër në zgjedhje është thelbësore për përfaqësimin e tyre të barabartë në shoqëri. Duke votuar në mënyrë aktive, ata jo vetëm që shprehin zërin e tyre, por gjithashtu kontribuojnë për procese zgjedhore më gjithëpërfshirëse dhe më të drejta.

Ndërgjegjësimi i fuqishëm për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në zgjedhje konfirmohet nga përgjigjet e personave të verbër, përkatësisht, madje 77% e të anketuarve deklaruan se kanë votuar, pa dallime të rëndësishme sipas gjinisë ose përkatësisë etnike.




Grafiku 9/Tabela 4/Grafiku 10: numri dhe përqindja e pjesëmarrësve që votuan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike etnisë dhe moshës.

Pjesëmarrja më e lartë është vërejtur tek të anketuarit e moshës 50 deri në 65 vjeç, që tregon se gjeneratat e pjekura kanë shprehi dhe ndjenjë më të madhe përgjegjësie ndaj procesit zgjedhor. Kjo, nga ana tjetër, ngre dilemën e pjesëmarrjes më të ulët tek gjeneratat e reja, gjë që mund të sinjalizojë nevojën e përpjekjeve të mëtejme për të motivuar dhe edukuar personat e rinj të verbër në mënyrë që të forcohet pjesëmarrja e tyre aktive politike.

Analiza e të dhënave në veçanti për secilën nga komunat e përfshira dhe për qytetin e Shkupit zbulon rezultate inkurajuese. Pjesëmarrja në komunat jashtë Shkupit është diçka më e lartë krahasuar me ato që i përkasin kryeqytetit. Kjo tregon se, pavarësisht qasjes më të ulët të informacionit dhe shërbimeve në zonat rurale dhe ato më të vogla, ndërgjegjësimi për rëndësinë e votimit dhe ndjenja e detyrës qytetare janë jashtëzakonisht të fuqishme. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja më e ulët në Shkup ngre pyetjen vallë mjedisi urban, me më shumë alternativa dhe stile të ndryshme jetese, krijon nivel të caktuar apatie ose ulje motivimi për pjesëmarrje aktive në procesin zgjedhor.

A kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024?




Grafiku 11: numri i pjesëmarrësve që votuan në zgjedhjet parlamentare 2024 sipas komunave

Në pyetjen pse nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës, të anketuarit më së shpeshti si arsye e kanë përmendur aftësinë e tyre të kufizuar, zhgënjimin në sistem dhe mosbesimin ndaj partive politike. Këto përgjigje tregojnë një barrierë të dyfishtë: nga njëra anë, ekzistojnë pengesa reale fizike dhe logjistike që vështirësojnë votimin, ndërsa nga ana tjetër, mungesa e besimit në institucionet dhe në subjektet politike krijon ndjenjën e përjashtimit dhe demotivimit. Ky rezultat nxjerr në pah nevojën për një qasje të dyfishtë: përmirësimin e qasjes dhe mbështetjes praktike për personat me aftësi të kufizuara gjatë votimit, por edhe ndërtimin e besimit përmes transparencës, politikave gjithëpërfshirëse dhe dialogut të hapur me komunitetin. Vetëm me një përgjigje të kombinuar ndaj këtyre sfidave mund të zvogëlohet numri i atyre që heqin dorë nga e drejta e tyre zgjedhore.

Ku votojnë personat e verbër?

Siç është shënuar në analizën e kornizës ligjore, Kodi Zgjedhor mundëson që votimi i personave me aftësi të kufizuara të zhvillohet si në vendvotim, ashtu edhe në kushte shtëpiake, një procedurë që është menduar kryesisht për personat e sëmurë dhe të pafuqishëm. Në këtë rast, autoritetet zgjedhore nuk i evidencojnë personat e verbër si kategori e veçantë, por ata përfshihen në numrin e përgjithshëm të personave të sëmurë dhe të pafuqishëm. Kjo metodë e evidencimit e pamundëson përcjelljen e daljes së tyre reale dhe pjesëmarrjes në zgjedhje, gjë që është thelbësore për krijimin e politikave dhe masave të përshtatshme. Ofrimi i statistikave të sakta mbi numrin e votuesve të verbër do të ishte një hap i rëndësishëm drejt transparencës më të madhe dhe mundësimit të aktiviteteve të synuara për avancimin e përfshirjes së tyre zgjedhore.




Grafiku 12/13: Përqindja e pjesëmarrësve që votuan në një qendër votimi ose në shtëpi, ndarja sipas moshës

Të dhënat e analizës tregojnë se madje 83% e të anketuarve kanë votuar në vendvotim, pa dallime të dukshme sipas gjinisë apo përkatësisë etnike. Aspekti i moshës është veçanërisht interesant: habit fakti se deri në dy të tretat e personave mbi 65 vjet kanë arritur të votojnë drejtpërdrejt në vendvotim. Kjo e dhënë është e rëndësishme sepse tregon se, përkundër rritjes së sfidave shëndetësore dhe mobile të personat e moshuar, ata megjithatë e tregojnë vendosmërinë dhe angazhimin e tyre ndaj procesit zgjedhor. Në të njëjtën kohë, kjo ngre gjithashtu pyetje për atë se vallë institucionet po ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për të lehtësuar pjesëmarrjen e kësaj grupmoshe dhe për të zvogëluar pengesat e mundshme në zgjedhjet e ardhshme lokale në vitin 2025.

Nëse analizojmë vendndodhjen e votimit të personave të verbër sipas komunave, grafiku i mëposhtëm tregon se shumica e personave të verbër në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 votuan në një vendvotim, veçanërisht në Shkup, ku pothuajse nuk ka votim në kushte shtëpiake. Në anën tjetër, jashtë kryeqytetit, disa komuna si Kërçova, Kavadar, Prilepi dhe Koçani kanë një numër të konsiderueshëm votuesish që kanë votuar në shtëpi.

Arsyet kryesore për të votuar në shtëpi të anketuarit i përmendën shëndetin dhe moshën, pamundësinë për të votuar me shoqërues, prania e privatësisë më të madhe në kushte shtëpiake, si dhe qasja e dobët në vendvotime. Këto përgjigje tregojnë se përveç pengesave infrastrukturore, ka edhe pengesa që lidhen me transportin ose mungesën e mbështetjes personale.



Grafiku 14: Pjesëmarrësit që votuan në një qendër votimi ose në shtëpi, ndarja sipas komunave

Këto të dhëna tregojnë gjithashtu se zonat urbane ofrojnë kushte më të mira për pjesëmarrje aktive në vendvotime, ndërsa komunat rurale kërkojnë mbështetje të mëtejme logjistike dhe institucionale. Për të avancimin e gjendjes, nevojitet përmirësimi sistematik i qasshmërisë, sigurimi i shoqëruesve dhe transportit ku është e nevojshme, si dhe procedura të thjeshtuara për votimin në kushte shtëpiake. Kjo do të lejojë barazi dhe pavarësi më të madhe në ushtrimin e të drejtës zgjedhore.


Në ç'mënyrë votojnë personat e verbër kur janë në vendvotim?

Analiza e të dhënave tregon se shumica dërrmuese e personave të verbër të anketuar që votuan në vendvotim, këtë e bënë me ndihmën e një personi tjetër (97%), ndërsa vetëm 3% përdorën shabllonin me alfabetin e Brajit. Kjo tregon se pavarësisht ekzistencës së mjetit që mundëson votimin e pavarur dhe të fshehtë, përdorimi i tij mbetet minimal.



Grafiku 15: Pjesëmarrësit që votuan me ndihmën e një personi tjetër ose duke përdorur një shabllon dhe alfabetin e Brajit

Sa i përket gjinisë, gratë diçka më shpesh e kanë përdorur alfabetin e Brajit (5 gra) krahasuar me burrat (1 burrë). Kjo mund të interpretohet si një gatishmëri ose interes më i madh midis grave për të përdorur mjetin për votim të pavarur, megjithëse shifrat janë shumë të vogla për gjeneralisim.



Grafiku 16: Pjesëmarrësit që votuan me ndihmën e një personi tjetër ose duke përdorur një shabllon dhe alfabetin e Brajit, ndarja sipas gjinisë

Sipas moshës, përfaqësim më të lartë votimi me shabllonin e Brajit ka tek të rinjtë e moshës 18-29 vjeç, dhe vijojnë ata të moshës 30-49 vjeç. Tek personat mbi 50 vjet, ku numri i votuesve është dukshëm më i lartë, pothuajse të gjithë mbështeten në ndihmën e një personi tjetër, gjë që tregon se me moshën, varësia nga shoqëruesit rritet dhe përdorimi i zgjidhjeve të arritshme teknike zvogëlohet.


Mosha	Në ç'mënyrë kanë votuar në vendvotim?	
	Me ndihmën e një personi tjetër	Me shabllon dhe alfabetin e Brajit
18 - 29 vjet	7	2
30 - 49 vjet	51	3
50 - 65 vjet	63	
mbi 65 vjet	61	1
Gjithsej	182	6

Tabela 5: Pjesëmarrësit që votuan me ndihmën e një personi tjetër ose duke përdorur shabllon dhe alfabetin e Brajit, ndarja sipas moshës


Nga e lartpërmendura, mund të konkludohet se, megjithëse alabeti i Brajit është një mjet për pavarësi dhe konfidencialitet më të madh të zërit tek personat e verbër, ai ende është i margjinalizuar në praktikë. Është e rëndësishme të theksohet se Braji nuk është një gjuhë e veçantë, por një sistem universal shkrimi që mund të përshtatet në të gjitha gjuhët, përfshirë maqedonishten dhe shqipen, përmes kodifikimeve të veçanta për secilin alfabet. Kjo do të thotë që me trajnim dhe standarde të përshtatshme, kushdo që njeh Brajin mund të lexojë dhe të shkruajë në gjuhë të ndryshme. Me edukim sistematik, mbështetje institucionale dhe përparim teknik, përdorimi i tij mund të rritet ndjeshëm dhe të kontribuojë për një nivel më të lartë të barazisë zgjedhore.

Kush ofron mbështetje gjatë votimit në vendvotime?

Nëse i analizojmë të anketuarit që votuan nëvendvotim me ndihmën e një personi tjetër për sa i përket asaj se kush shfaqet në rolin e personit tjetër, numrat tregojnë me sa vijon:



Grafiku 17: Kush i ndihmoi pjesëmarrësit të votonin



Grafiku 18: Kush i ndihmoi pjesëmarrësit të votonin, ndarja sipas gjinisë

Gjatë votimit në vendvotime shumica e personave me shikim të dëmtuar morën mbështetje nga anëtarët e familjes ose të afërmit (68%). Kjo tregon se rrjeti familjar mbetet burimi kryesor i mbështetjes, gjë që mund të jetë praktike, por edhe e rrezikshme për sa i përket sigurimit të fshehtësisë dhe pavarësisë së plotë të votës. Burimi i dytë më i madh i ndihmës janë asistentët personalë (22%), që është një sinjal pozitiv se shërbimi i ndihmës personale po njihet dhe përdoret gjithnjë e më shumë. Megjithatë, ka edhe situata kur këshilli zgjedhor ka caktuar personin mbështetës (7%) ose ndihma është ofruar nga votuesi tjetër (2%), gjë që ngre pyetje në lidhje me përshtatshmërinë dhe fshehtësinë e votës gjatë zbatimit të kësaj praktike pavarësisht se është në përputhje me udhëzimet e KSHZ-së.

Sa i përket gjinisë, shifrat janë të ngjashme si për gratë ashtu edhe për burrat: të dyja grupet mbështeten kryesisht të anëtarët e familjes, përderisa asistentët personalë përfaqësohen nga 20 gra dhe 23 burra.

Mund të konkludohet se gjendja aktuale tregon varësinë e lartë të familjes, por edhe potencialin për përdorimin më të madh të asistentëve personalë dhe të zgjidhjeve teknike për votim të pavarur. Përmirësimi i këtyre segmenteve do të kontribuojë në drejtim të një procesi zgjedhor më të lirë, më transparent dhe më të denjë për personat me shikim të dëmtuar.

Si ta përmirësohet kjo gjendje?

Në pyetën se si të përmirësohet gjendja, personat e verbër kanë një sërë kërkesash dhe sugjerimesh specifike për avancimin e procesit zgjedhor dhe mundësimin e qasjes së barabartë gjatë votimit. Më së shpeshti përmendet nevoja e qasjes më të mirë në vendvotime, qasjes fizike më të lehtë, shtigjeve të prekshme, hyrjes së veçantë, etj. Një numër i madh përgjigjesh gjithashtu tregojnë për rëndësinë e mundësimin të votimit me asistent personal, me qëllim që personat të mund të ushtrojnë të drejtën zgjedhore në mënyrë të besueshme dhe me dinjitet.

Më tej, disa të anketuar konsiderojnë se shabllonet e Brajit nuk janë aq të dobishme, pasi një pjesë e madhe e personave të verbër nuk e njohin alfabetin e Brajit. Në këtë drejtim, në vend të përmirësimit të vetë shablloneve, ata theksojnë nevojën për një qasje të dyfishtë: nga njëra anë, edukim dhe trajnim sistematik për përdorimin e alfabetit të Brajit, dhe nga ana tjetër, përsosje teknike të shablloneve - që të jenë më të qarta, më të trasha dhe me informacion të shënuar qartësisht.

Vërejtje të tjera të spikatura i referohen nevojës për trajnim dhe informacion më të madh si për anëtarët e këshillave zgjedhore ashtu edhe për vetë votuesit, si dhe krijimin e zgjidhjeve ligjore që do të ofrojnë më shumë përfitime për personat me aftësi të kufizuara. Propozohet gjithashtu një rol më i madh i institucioneve në krijimin e kushteve për votim të arritshëm, si dhe ofrimin e më shumë të drejtave dhe kujdesit për këtë kategori qytetarësh. Disa nga të anketuarit kërkojnë gjithashtu mundësinë e votimit në kushte shtëpiake, si një zgjidhje që siguron privatësi dhe ushtrim më të lehtë të së drejtës së votës.

Konkludimi nga këto përgjigje është se për të përmirësuar përvojën zgjedhore të personave të verbër, nevojitet një qasje e integruar që kombinon zgjidhjet infrastrukturore (qasshmërinë dhe shabllonet), masat institucionale (trajnimin, ligjet, mbështetjen për asistentët personalë) dhe autonominë individuale (mundësinë e zgjedhjes ndërmjet votimit në vendvotim ose në kushte shtëpiake). Në këtë mënyrë, procesi zgjedhor do të bëhet më i arritshëm, më i denjë dhe vërtet i barabartë për të gjithë.

ANALIZË-ASISTENTËT PERSONALË

Asistentët personalë janë një formë mbështetjeje e rregulluar në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen Sociale dhe akteve nënligjore që lidhen me shërbimet për personat me aftësi të kufizuara. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ky shërbim u prezantua për herë të parë me reformat në sistemin e mbrojtjes sociale në vitin 2019, kur shteti filloi të njohë institucionalisht rolin e asistentëve personalë si një mjet për rritjen e pavarësisë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.

Funksioni i asistentit personal është të sigurojë ndihmë praktike në funksionimin e përditshëm, siç është lëvizja, komunikimi dhe qasja në shërbimet publike, por gjithmonë nën drejtimin dhe zgjedhjen e vetë personit. Në kontekstin e procesit zgjedhor, asistentët personalë mund të luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm: ata mund të shoqërojnë personat e verbër në vendvotim, t'u ndihmojnë gjatë orientimit në hapësirë, t'i informojnë rreth pamjes teknike të fletëvotimit dhe shabllonit të Brajit, si dhe të ofrojnë mbështetje diskrete në mënyrë që personi të mund të votojë në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë.

TË DHËNA DEMOGRAFIKE DHE GJEOGRAFIKE

Analiza bazohet në përgjigjet e 225 asistentëve personalë, me ç'rast gratë marrin pjesë me 149 të anketuara, ndërsa burrat me 76 të anketuar. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve i përket grupmoshës 30 deri në 49 vjeç, ndërsa të rinjtë deri në 29 vjeç dhe ata të moshës 50 - vjeçare e lart përfaqësohen pothuajse në mënyrë të barabartë (25% dhe 23%). Përbërja etnike pasqyron gjithashtu diversitetin në vend: shumica e të anketuarve janë maqedonas (75%), vijojnë shqiptarët (17%), romët (4%) dhe të tjerë.

Përfaqësimi gjinor




Grafiku 19: Përfaqësimi i pjesëmarrësve sipas gjinisë

Përfaqësimi sipas moshës




Grafiku 20: Përfaqësimi i pjesëmarrësve sipas moshës

Përfaqësimi sipas përkatësisë etnike




Grafiku 21: Përfaqësimi i pjesëmarrësve sipas etnisë

Shpërndarja gjeografike e të anketuarve përfshin 37 komuna, me përfaqësimin më të lartë në Kërçovë, Shtip dhe Koçan.



Grafiku 22: Numri i pjesëmarrësve sipas komunave

Përfaqësimi gjeografik



Vetëm 9% e asistentëve personalë për personat e verbër janë në Shkup, ndërsa 91% janë jashtë kryeqytetit. Kjo tregon se pjesa më e madhe e mbështetjes sigurohet në komunat më të vogla dhe zonat rurale, ku mungesa e shërbimeve institucionale rrit nevojën për asistentët personalë.

Grafiku 23: përqindja e pjesëmarrësve nga Shkupi dhe jashtë Shkupit

GJETJET NGA ANALIZA E PËRGJIGJEVE TË ASISTENTËVE PERSONAL

Asistentët personalë si pjesë integrale e organeve zgjedhore

Nga gjithsej 225 asistentët personalë të anketuar, 47 prej tyre, përkatësisht rreth 21%, deklaruan se kishin qenë anëtarë të organeve zgjedhore. Këto të dhëna janë të rëndësishme sepse tregojnë se disa nga asistentët kanë përvojë të drejtpërdrejtë me procesin zgjedhor dhe procedurat e votimit, gjë që mund të rrisë kompetencën dhe besimin e tyre në mbështetjen e personave të verbër. Përvoja e këtillë u mundëson që të informojnë dhe udhëzojnë më mirë personat me aftësi të kufizuara, të ndihmojnë në kapërcimin e barrierave të mundshme dhe të zvogëlojnë frikën nga vetë procedura. Megjithatë, kjo ngre gjithashtu çështjen e nevojës për protokolle të qarta që do të garantojnë paanshmërinë dhe do të mbrojnë sekretin e votës, në mënyrë që të shmanget çdo ndikim në vendimin zgjedhor. Më tej, 79% e asistentëve të tjerë personalë që nuk kanë një përvojë të këtillë me proceset zgjedhore kanë nevojë për trajnime dhe udhëzime të synuara, në mënyrë që të barazohet niveli i njohurive dhe të të gjithë të mund të ofrojnë mbështetje të përshtatshme, të besueshme dhe profesionale për personat e verbër gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre të votës.

Nevojë për trajnim të specializuar

Prej 225 asistentëve personalë të anketuar, madje 92 besojnë se nuk ka nevojë për trajnim për zgjedhjet e ardhshme lokale në vitin 2025, gjë që tregon perceptimin e gabuar për rolin e tyre dhe kompleksitetin e procesit zgjedhor. Vetëm 16 persona kanë kaluar trajnimin formal, dhe vetëm nga një organizator, gjë që thekson më tej kufizimet e ofertës ekzistuese dhe varësinë nga një burim i vetëm. Edhe pse 47 asistentë kanë shoqëruar tashmë një person të verbër për të votuar, përvoja e tyre praktike shpesh nuk mbështetet nga njohuritë dhe udhëzimet standarde, gjë që krijon rrezikun e mbështetjes jokonsistente dhe jo të mjaftueshme. Mungesa e vetëdijes për atë se trajnimi është i nevojshëm, e jo opsional, tregon nevojën për një qasje të institucionalizuar dhe sistematike për ndërtimin e kapaciteteve.

Në kushtet kur asistentët personalë janë një urë kyçe për votim të pavarur dhe të fshehtë, trajnimi i këtillë i pamjaftueshëm paraqet sfida serioze për procesin zgjedhor. Për të kapërcyer këtë problem, është e nevojshme të rritet dhe diversifikohet oferta e trajnimit, me përfshirjen aktive të KSHZ-së, institucioneve arsimore dhe organizatave të shoqërisë civile. Përmes trajnimeve të rregullta dhe të standardizuara, mund të sigurohet mbulim i mbarë vendit dhe nivel i barabartë i kompetencës të të gjithë asistentët. Në këtë mënyrë, si ata që tashmë kanë përvojë praktike, ashtu edhe ata që ende nuk janë përballur me këtë rol do të kenë njohuritë dhe mjetet e duhura për të kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe të paanshme, duke kontribuar për një përfshirje dhe pjesëmarrje më të madhe dhe të barabartë të personave të verbër në procesin zgjedhor.

REKOMANDIME

Pjesa më e madhe e rekomandimeve janë dhënë në pjesët përkatëse në tekstin e analizës, por për qartësi më të mirë po i përsërisim këtu në grup varësisht se kujt i dedikohen ato.

Organet zgjedhore

- Të vihet evidencë e posaçme statistikore në Formularin 16 për përmbledhjen e rezultateve të votimit, me ç'rast në kategorinë e personave të sëmurë dhe të pafuqishëm që kanë votuar në kushte shtëpiake të mbahet evidencë edhe për personat e verbër, me qëllim planifikimin e masave mbështetëse, si dhe përcjelljen e pjesëmarrjes. Ky rekomandim mund të zbatohet nëpërmjet një qasjeje me faza, duke e testuar atë vetëm në disa zona zgjedhore.
- Të përshkruhen standardet minimale detyruese: çdo vendbanim të ketë në dispozicion, të shfaqë qartë dhe të mbajë një regjistër për shabllonet e Brajit.
- Të investohet në përmirësimin teknik të shablloneve të Brajit, d.m.th. vija më të trasha, simbole më të qarta dhe mbështetje dygjuhëshe.
- Të përfshihen mikro-trajnime të detyrueshme për këshillat zgjedhore ose t'i jepet fokus i veçantë trajnimit ekzistues mbi punën me personat e verbër dhe protokolle të standardizuara të ndihmës (mbrojtja e konfidencialitetit/paanshmërisë; udhëzime të shkurtra në dispozicion publik, përfshirë audion, para zgjedhjeve).
- Të bëhen verifikimet parazgjedhore të qasshmërisë (lista e kontrollit dhe procesverbalet) me afate korigjuese para ditës së votimit, si dhe mbikëqyrje dhe sanksione të përshtatshme për vetëqeverisjet vendore për mosrespektimin e standardeve të përcaktuara të qasshmërisë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Arsimi dhe forcimi i vetëdijes

- Të futet arsimi sistematik për shkrimin e Brajit në arsimin e rregullt dhe joformal, me fokus te të rinjtë dhe zonat rurale.
- Të kombinohet edukimi për shkrimin e Brajit me teknologjitë digjitale (lexues ekrani, aplikacione mobile) për të rritur motivimin dhe qasjen.
- Për votuesit që votojnë për herë të parë dhe në bashkëpunim me KSHZ-në, të promovohet përdorimi i shablloneve të Brajit përmes fushatave publike dhe demonstrimeve praktike në periudhën ndërmjet zgjedhjeve dhe aty para zgjedhjeve.

Asistentët personalë dhe mbështetja gjatë votimit

- Të sigurojë trajnim të detyrueshëm për asistentët personalë për procesin zgjedhor, të organizuar nga KSHZ-ja në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe organizatat e shoqërisë civile.

- Të diversifikohet oferta e trajnimit (të mos varet nga një organizator i vetëm), me qëllim mbulimin më të gjerë në të gjitha rajonet.
- Të zhvillohen protokolle për paanshmërinë dhe mbrojtjen e sekretit të votës gjatë asistencës.
- Të krijohet regjistër i asistentëve të trajnuar personalë që mund të angazhohen gjatë zgjedhjeve.

Përfshirje dhe besim në procesin zgjedhor - KSHZ dhe sektorin e shoqërisë civile

- Të zhvillohen fushata të synuara informuese për personat e verbër (dhe familjet e tyre) në lidhje me të drejtat e tyre zgjedhore dhe mjetet në dispozicion.
- Të motivohet pjesëmarrja e të rinjve të verbër përmes programeve të specializuara për edukim qytetar dhe përfshirje në proceset demokratike.
- Të ndërtohet besimi përmes komunikimeve transparente dhe të hapura me komunitetin, me konsultime dhe informata kthyesë rreth përgatitjeve zgjedhore.

